



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:298865

Datë: 22.02.2021

Numri i dokumentit: 01528592

C.nr.1239/19

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Besnik Bislímaj, me zyrtaren ligjore Merita Xharavina, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit M. A. nga Gjakova të cilin e përfaqëson i autorizuari Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit në emër të ushqimit në punë (shujtës) dhe shpërblimit jubilar, vlera e kontestit 2,314.00 euro, pas mbajtjes së seancës kryesore publike të datës 26.01.2021, më datë 22.02.2021, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit M. A. nga Gjakova, ashtu që:

II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit që në emër të kompensimit për ushqimin për praninë në punë për periudhën kohore 01.01.2015 e gjer më 29.02.2020, për ditët totale të pranisë në punë prej 1157 ditë dhe atë (për secilën ditë të pranisë në punë shumen nga 2 euro) paditësit M. A. nga Gjakova, t'ia paguajë shumën totale prej 2,314.00.-€ (dymijë e treqind e katërmbëdhjetë euro), me kamatë prej 8%, duke filluar nga dita nxjerrja e këtij aktgjykimi, me datë 22.02.2021 e deri në pagesën definitive si dhe **DETYROHET** e paditura që në emër të pagesës për shpenzimet e procedurës, paditësit t'ia paguajë shumën totale prej 269.00 euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

III. Padia e paditësit M. A. nga Gjakova, e parashtruar kundër të paditurës Komuna e Gjakovës-Drejtoria e Arsimit, në lidhje me kompensimin e shpërblimit jubilar, **konstatohet e tërhequr.**

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor i çështjes është mbajtur në mungesë të të paditurës, në kuptim të nenit 423 par.4 të LPK-së.

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi M. A. nga Gjakova, përmes të autorizuarit të tij Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, pranë kësaj gjykate, më datë 27.12.2019, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, ku ka theksuar se paditësi është punësuar si staf tekniko shërbyes në SHMU "Mazllum Këpuska" në Gjakovë. Paditësit nuk i është kompensuar ushqimi në punë për ditët e punës ashtu që duke pasur parasysh se e paditura ka obligim të paguajë nga 2 euro për çdo ditë pune, ka kërkuar kompensimin për ushqim në emër të ditëve të

pranisë në punë dhe shpërblimin jubilar për 22 vite përvojë pune, si dhe ka kërkuar kamatën ligjore dhe shpenzimet e procedurës. Me datë 29.12.2020 i autorizuari i paditësit Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, ka bërë precizimin e kërkesëpadisë sa i përket ditëve të pranisë në punë për paditësin, ku në emër të ushqimisë për 1157 ditë në punë ka kërkuar shumën prej 2,314.00 euro ndërsa nga kërkesa për shpërblimin jubilar tani për tani është tërhequr, pasi që për të njëjtën do të inicojë kontest të ri pasi që të plotësohet dokumentacioni përkatës nga paditësi.

Në seancën për shqyrtim kryesor i autorizuari i paditësit Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë parashtrimeve të theksuara në padi dhe në parashtrës të datës 29.12.2020 dhe 09.06.2020, ashtu që i ka propozuar gjykatës që të administrojë provat e bashkangjitura në padi dhe në parashtrës të cituara më lartë, mbi bazën e të cilave do të vërtetohet baza dhe lartësia e kërkesëpadisë. Gjersa në fjalën e tij përfundimtare, i njëjti ka deklaruar se gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor në bazë të provave të administruara në ndërlidhje me bazën ligjore e cila rrjedhë nga Ligji i Punës më ndërlidhje me Kontratat Kolektive të cilat janë në fuqi nga viti 2015 përkatësisht viti 2017 e që janë në kontinuitet njëra me tjetrën vërtetohet se këtu paditësit i takon e drejta në kompensim të shujtave të ushqimit dhe atë nga 2.00 euro për çdo ditë të paraqitjes në punë ashtu që në bazë të vërtetimit të lëshuar nga SHMU “Mazllum Këpuska” është vërtetuar se këtu paditësi për periudhën kohore nga data 01.01.2015 e deri me datë 29.02.2020 ka gjithsej 1157 ditë të paraqitjes në punë e që të njëjtit duhet t’i takojnë në emër të kompensimit të shujtave të ushqimit shuma prej 2,314.00 euro, ashtu siç është precizuar edhe në parashtrësën e datës 29.12.2020. I ka kërkuar shpenzimet procedurale dhe atë për taksë gjyqësore prej 30.00 euro, për përpilimin e padisë shumën prej 104.00 euro, për prezantimin e seancës shumën prej 135.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 269.00 euro.

E paditura në përgjigjen në padi kaq theksuar se e kundërshtojë në tërësi padinë dhe kërkesë padinë si të pa bazuar me arsyetimin se Komuna e Gjakovës nuk është nënshkruese e kontratës Kolektive të Arsimit si dhe nuk ka buxhet të mjaftueshëm për pagesën e këtyre mjeteve pasi që MASHT-i dhe SBASHK-u, nuk janë të angazhuar për ti informuar dhe ndihmuar Komunat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos buxhetore për zbatimin e kësaj kontrate në Ministrinë e Financave me qëllim të realizimit të buxhetit etj.. dhe ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesë padinë e paditësit ta refuzoj si të pa bazuar.

Gjendja faktike e vërtetuar

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në shqyrtimin kryesor-publik nxori dhe administroi këto prova: Kontrata e Punës me numër 13/124 e datës 01.09.2015, Vërtetimi i lëshuar nga SHMU “Mazllum Këpuska” në Gjakovë me numër të protokollit 63-24/2019 të datës 06.06.2019, Vërtetimi i lëshuar nga SHMU “Mazllum Këpuska” në Gjakovë me numër të protokollit 73-5/2020 të datës 16.09.2020, Kontrata e Punës e datës 01.09.2015.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palës paditëse dhe provave të nxjerra, në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e **bazuar**.

Nga Kontrata e Punës me numër 13/124 e datës 01.09.2015, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi M. A. nga Gjakova është i punësuar te e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit në Gjakovë, si punëtor teknik me orar të plotë 40 orë pune në javë dhe i cili ende vazhdon të punojë në të njëjtin vend të punës.

Nga Vërtetimi i lëshuar nga SHMU “Mazllum Këpuska” në Gjakovë me numër të protokollit 63-24/2019 të datës 06.06.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi M. A. nga Gjakova në këtë institucion arsimor përkatësisht në SHMU “Mazllum Këpuska” në Gjakovë ka punuar gjithsej 22 vite.

Nga Vërtetimi i lëshuar nga SHMU “Mazllum Këpuska” në Gjakovë me numër të protokollit 73-5/2020 të datës 16.09.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi M. A. nga Gjakova në këtë institucion arsimor përkatësisht në SHMU “Mazllum Këpuska” në Gjakovë ka punuar gjithsej 1157 ditë pune.

Nga Kontrata e Punës e datës 01.09.2015, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi M. A. nga Gjakova është i punësuar te e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit në Gjakovë, si punëtor shërbyes me orar të plotë 40 orë pune në javë.

Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Gjykata nga administrimi i provave dhe deklarimeve të palëve ndërgjyqëse ka vërtetuar se nuk është kontestues fakti që paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura, përkatësisht punon si staf tekniko shërbyes në SHMU “Mazllum Këpuska” në Gjakovë, në vitet shkollore 2014/2015, 2015/2016, 2016/2017, 2017/2018, 2018/2019 dhe 2019/2020 deri me datë 29.02.2020 (vite këto për të cilat paditësi kërkon kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë dhe atë nga data 01.01.2015 e gjer më 29.02.2020), ky fakt u vërtetua nga këto prova: Kontrata e Punës me numër 13/124 e datës 01.09.2015, Vërtetimi i lëshuar nga SHMU “Mazllum Këpuska” në Gjakovë me numër të protokollit 63-24/2019 të datës 06.06.2019, Vërtetimi i lëshuar nga SHMU “Mazllum Këpuska” në Gjakovë me numër të protokollit 73-5/2020 të datës 16.09.2020, Kontrata e Punës e datës 01.09.2015.

Gjykata, nga provat në shkresat e lëndës, konkretisht nga vërtetimi i lëshuar nga e paditura, gjegjësisht drejtori i SHMU “Mazllum Këpuska” në Gjakovë me numër të protokollit 73-5/2020 të datës 16.09.2020 ka vërtetuar faktin se paditësi ka punuar gjithsej 1157 ditë pune në periudhën kohore 01.01.2015 e gjer më 29.02.2020, atëherë gjykata vendosi si në pikën **II** të dispozitivit të këtij aktgjykimit, për të cilat i është aprovuar shuma nga 2 euro për çdo ditë të pranisë në punë, shumë kjo e përcaktuar në Kontratën Kolektive te Arsimit.

Gjykata, lidhur me vendosjen sipas pikës **II** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, iu referua nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit me nr. 01B-2056 e datës 18.04.2017, në të cilën parashihet se *“Të punësuarve u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kane marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restorantit apo kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*. E po ashtu, një gjë të tillë e ka paraparë edhe Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nr.36 e cila ka hyrë në fuqi me datën 01.01.2015, e cila në nenin 54 par.1 ka përcaktuar se *“të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës (prej 8 orë), për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy (2) euro, varësisht nga rrethanat dhe mundësitë për rastet konkrete”*. Prandaj, mbi këto baza, gjykata konstatoi se punëdhënësi i paditësit është pikërisht e paditura me çka vërtetohet edhe nga kontrata e punës që gjendet në shkresat e lëndës, andaj raporti juridik i paditësit me të paditurën të njëjtën e bën legjitime dhe me detyrim për pagesën e detyrimeve sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata, po ashtu me rastin e vendosjes pati parasysh edhe nenin 90 par.5 te Ligjit te Punës nr. 03/L-212, në të cilën parashihet *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe*

punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”, ndërsa në nenet e përcaktuara të lartëcituara është paraparë detyrimi i punëdhënësit në rastin konkret të paditurës për kompensimin e ushqimit në punë edhe pse të njëjtit nuk janë nënshkruar të Kontratës Kolektive të Arsimit, e njëjta e nënshkruar nga Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditësit dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë për paditësin.

Gjykata, me rastin e vendosjes pati parasysh edhe kundërshtimet e përfaqësuesit ligjor të të paditurës të dhëna në përgjigje në padi, në lidhje me atë se e paditura nuk është nënshkruese e kontratës kolektive të datës 18.04.2017, si dhe nuk ka buxhet të mjaftueshëm për pagesën e këtyre mjeteve të kërkuara, mirëpo gjykata këto pretendime i refuzoi si të pa bazuar për arsye se paditësi nuk është përgjegjës për planifikimin e buxhetit për obligimet që dalin nga kontrata e lartcekur. Përveç kësaj dispozita e nenit 46 të kësaj kontrata ka karakter udhëzues e jo imperativ apo detyrës dhe se nuk është bazë juridike për refuzimin e kërkesëpadisë.

Meqë lidhur me kërkesën për shpërblimin jubilar, i autorizuari i paditësit është tërhequr me parashtrësën mbi precizimin e kërkesëpadisë, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 261 par.2 të LPK-së, ashtu që vendosi si në pikën **III** të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata analizoi edhe pretendimet dhe deklaratimet tjera të palëve ndërgjyqëse, por të njëjtat nuk i morri për bazë pasi që të njëjtat nuk kanë ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit dhe atë në emër të taksës gjyqësore shumë prej 30.00 euro, në emër të përpilimit të padisë shumë prej 104.00 euro, në emër të prezantimit në seancë shumë prej 135.00 euro, përkatësisht shumë e përgjithshme prej 269.00 euro.

Prandaj, gjykata, bazuar ne arsyet e cekura me larte, bazuar ne nenin 143 paragrafi 1 te LPK-së, vendosi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.1239/19, datë 22.02.2021

Zyrtare ligjore
Merita Xharavina

GJYQTARI,
Besnik Bislimaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita vijuese pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate.